



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr 1463 Prot.

Tiranë, më 07 . 10 . 2024

V E N D I M

Nr.4, datë 27.09.2024

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR” ME QËLLIM NDËRTIMIN E STRUKTURAVE ANKORUESE, PORTUALE NË DET, TË SUBJEKTIT “SHOQËRIA KONCESIONARE MARINA RODON” SH.P.K, ME VENDNDODHJE: PORTI I RODONIT, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA DURRËS, QARKU DURRËS

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje, “Për përdorim burimi ujor”, me qëllim ndërtimin e strukturave ankoruese, portuale në det, të subjektit “Shoqëria Koncesionare Marina Rodon” sh.p.k, me vendndodhje: Kepi i Rodonit, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, Qarku Durrës.
2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:

Emri i burimit ujq: Deti Adriatik.

Vendndodhja e burimit ujq (KRGJSH).

Porti i jahteve "Marina Rodon"

Pika 1-	X= 460510.71	Y= 4603929.74	Z= 0.35 m.m.n.d
Pika 2-	X= 460448.14	Y= 4604278.01	Z=-4.62 m.m.n.d
Pika 3-	X= 460613.19	Y= 4604408.39	Z=-5.32 m.m.n.d
Pika 4-	X= 460685.32	Y= 4604444.74	Z=-5.86 m.m.n.d
Pika 5-	X= 460694.70	Y= 4604374.69	Z=-5.17 m.m.n.d
Pika 6-	X= 460767.41	Y= 4604316.48	Z=-4.81 m.m.n.d
Pika 7-	X= 460826.69	Y= 4603986.53	Z= 0.1 m.m.n.d

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet: Ndërtimin e Portit të jahteve "Marina Rodon" në detin Adriatik, Ishëm, Durrës.

- Gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të kësaj strukture, të lejohet kalimi i qetë i mjeteve lundruese që do të përdorin pjesë të tjera të gjirit jashtë objektit të koncesionit, të cilat nuk pengojnë aktivitetin e Portit dhe të jetë në përputhje me legjislacionin dhe udhëzimet/rregulloret/urdhërat përkatës në fuqi;
- Vendimi Nr. 7, datë 31.05.2023 i KKKU-së për miratimin e Lejes "Për ndërtimin e strukturave ankoruese, portuale në det", me Nr.Serial:00052 dhe Nr.1 Prot., datë 16.06.2023 shfuqizohet;
- Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi;

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

ZËVËNDESKRYEMINISTRI

BELINDA BAELUKE

**AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

GERTA LUBONJA